



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 774/4 Prot.

Tiranë, më 11.01. 2016

V E N D I M
Nr. 2, datë 11.01.2016

*"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 774/1 prot., datë 12.11.2015"*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Fushë-Arrëz, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr. 774/1 prot., datë 12.11.2015, pas shqyrtimit të informacionit që përmban shkresa, regjistruar me nr. 774 prot., datë 06.11.2015, u krye hetimi administrativ për verifikimin e procedurës së ndjekur nga Bashkia Fush-Arrëz, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak ristrukturimi, të nëpunëses civile ***** , e cila ka kryer detyrën "Inspektore e Ndihmës Ekonomike", pranë kësaj bashkie.

Nga aktet e administruara rezulton se, shtetasja ***** , ka filluar marrëdhënien e punës me aktin nr. 46/2 datë 13.5.2012, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", që ishte efektiv në atë kohë, në pozicionin "Inspektore e Ndihmës Ekonomike", pranë Bashkisë Fushë-Arrëz .

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, bazuar në nenin 67, pika 3 të tij dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, statusi i saj është rikonfirmuar për shkak të ligjit, pavarësisht, se njësia e burimeve njerëzore të institucionit, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, nuk ka e kryer detyrën, duke mos u shprehur në lidhje me statusin e

punësimit, si për këtë punonjëse, ashtu edhe për të gjithë punonjësit ekzistues të institucionit. Duke qenë se, punonjësja *****i plotëson të gjitha kushtet për të qenë, nëpunëse civile, duhet të trajtohet si e tillë, në raport me gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej legjislacionit të shërbimit civil.

Shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes që është objekt i këtij verifikimi, është ristrukturimi i institucionit, i diktuar nga hyrja në fuqi dhe veprimi i ligjit nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, dhe ligjit nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*.

Bazuar në dispozitat e akteve ligjore të përmendura më sipër dhe në ato të Kreut IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, me Vendimin nr. 10, datë 03.09.2015 *“Për Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, dhe të njësive administrative për vitin 2015 dhe niveli i pagave”*, ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative të saj. Në zbatim të saj, Kryetari i Bashkisë, ka miratuar me Urdhrin nr. 39, datë 29.09.2015, strukturën dhe organigramën e re.

Nga krahasimi i strukturës administrative të mëparshme të Bashkisë Fushë-Arrëz, me strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 39, datë 29.09.2015, konstatohet se nuk ka shkurtrim të pozicioneve të punës, (nga 50 punonjës që ishin më parë janë bërë 52 punonjës) por ka ristrukturim të tyre, që konsiston në riorganizimin dhe rikonceptimin e pozicioneve të punës.

Duke e analizuar më konkretisht rastin e punonjësës ***** , konstatohet se, Seksioni i Ndihmës Ekonomike, (ku ajo, punonte më parë) nuk përbëhet nga një specialist, ashtu si e parashikonte struktura e mëparshme, por është konceptuar si zyrë, në një nivel më të lartë nëpunësie, duke marrë emërtimin *“Zyra e Ndihmës Ekonomike”*, me një përgjegjës zyre.

Nisur nga ky riorganizim që ka pësuar struktura e Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe duke marrë parasysh faktin që niveli i nëpunësisë me strukturën aktuale është ngritur në një nivel më të lartë se niveli i nëpunësisë që kishte më parë kjo punonjëse, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me aktin nr. 39/6, datë 29.09.2015.

Në nxjerrjen e këtij akti, konstatohet se nuk janë respektuar rregullat dhe procedura e parashikuara nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin Civil”*, i ndryshuar; Vendimi nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*(kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*) dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, të Departamentit të Administratës Publike, duke anashkaluar kompetencën e Komisionit të Ristrukturimit dhe njësisë përgjegjëse.

Nga hetimi administrativ i praktikës dokumentare për mënyrën se si është proceduar në rastin konkret, është konstatuar se ekziston vetëm akti administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të ristrukturimit dhe mungojnë një sërë aktesh të tjera të domosdoshme, si: **a)**. Urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; **b)**. Dokumentacioni që materializon mënyrën si ka funksionuar ky komision dhe propozimet e tij në lidhje me transferimet, rëmërimet dhe lirimet nga shërbimi civil të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar, apo ristrukturuar pozicioni i punës; **c)**. Aktet administrative që provojnë marrjen e pëlqimit me shkrim nga nëpunësit të cilët janë të detyruar të transferohen në një pozicion tjetër për shkak të shkurtimit ose ristrukturimit të pozicionit të mëparshëm të punës; **ç)**. Aktet administrative që evidentojnë vendimmarrjen përfundimtare të njësisë përgjegjëse, për miratimin apo refuzimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit.

Nisur nga gjithë sa u analizua më sipër, konstatoj se, në nxjerrjen e aktit nr. 39, datë 29.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të ristrukturimit, të nëpunëses *****, nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat e parashikuara nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike, gjë e cila në bazë të nenit 115, pika “a”, dhe 116, shkronja “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” passjell pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ në fjalë. Ndodhur në këto kushte, në bazë të nenit 117 pika 1, të ligjit të mësipërm, akti nr. 39/6, datë 29.09.2015, i Kryetarit të Bashkisë Fush-Arrëz, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R. SH”; nenin 35 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e aktit administrativ nr. 39/6, datë 29.09.2015, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës sipas organikës vjetër e miratuar me VKB nr. 06, datë 10.03.2015 të nëpunësit *****”, si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.
2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Fush-Arrëz, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, duke respektuar radhën e punës dhe procedurën e parashikuar prej nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar; kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të

institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.

3. Në rastin e pamundësisë të sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet e parashikuara nga pikat 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe dy vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, të cilat lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje dhe arsye të tjera të ligjshme.
4. Në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse duhet të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, ku të paraqitet situata pas ristrukturimit e të materializohen si nëpunësit civilë të sistemuar pas ristrukturimit ashtu dhe ata që do të lirohen për shkak të shkurtimit të vendeve të punës.
5. Bashkia Fushë-Arrëz, për rastin e nëpunëses ******, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni, dhe pas këtij afati të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit, si dhe për ecurinë e procesit të ristrukturimit të institucionit, ashtu si është përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Fushë-Arrëz dhe kërkuesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA